POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Unaza e Madhe, hapet për qarkullim nënkalimi dhe rrethi i ri te TEG-u, Rama: Çliron ngërçin e trafikut! Ministrja e Infrastrukturës: Gati 85% e punimeve

2 Abetarja e unifikuar, gjuhëtarja për Report Tv: Shkronjat nuk do mësohen sipas alfabetit por sipas përdorimit! Nxit mendimin kritik

3  U sulmuan me armë, 2 policët në Vlorë po lëviznin me makinë me xhama të zinj! Dëshmia: Mendoi se i bëmë pritë e na qëlloi! Në kërkim autori me 3 emra

4  Faturim kromi në vend të duhanit, dosja në SPAK, 17 të kallëzuar për hapje të e 100 kompanive fantazmë! Mashtrim e vjedhje, në krye Xhevdet Hyseni

5  Ish spiun i sigurimit të shtetit? Partia e Lirisë i 'ndryshon' emrin kryetarit, nga Ilir Meta e prezanton si Metaj

Kronikë

Vrasja e Ismet Çekores në Shkodër, kamerat kapën autorin me motor! Shoqërohet Alban Bruçi, ndaj tij dyshohet se qëlloi djali i viktimës

Një person me motorr, me skafandë në kokë, është autori i vrasjes së 57 vjecarit Ismet Çekorja. Kjo është ajo çfarë kanë evidentuar kamerat e sigurisë në vendngjarje, në lagjen "Guerrilë" aty ku ekzekutua me 7 plumba pistolete 57-vjecari Ismet Çekorja.

Viktima e paralajmëroi 4 ditë më parë: Familjes sime i janë qepur shteti e bandat! (VIDEO)

Redaksia
3 Shtator, 10:30 | **Përditesimi: 3 Shtator, 11:32**

SHKODËR- Një person me motorr, me skafandë në kokë, është autori i vrasjes së 57-vjeçarit Ismet Çekorja. Kjo është ajo çfarë kanë evidentuar kamerat e sigurisë në vendngjarje, në lagjen "Guerrilë" aty ***ku u ekzekutua*** me 7 plumba pistolete 57-vjecari Ismet Çekorja.

Burime pranë grupit hetimor në Policinë e Shkodrës bëjnë me dije se drejtuesi i motorcikletës ka mbërritur me motor pranë vendit të ngjarjes, është ndalur, ka qëlluar ndaj 57 vjecarit dhe më pas është larguar me shpejtësi. Për shkak të skafandrës, është i pamundur identifikimi i autorit të ngjarjes, por blutë e Shkodrës kanë bërë edhe sekuestrimin e kamerave të tjera të sigurisë në segmente të tjera të Shkodrës, për të parë nëse në ndonjë moment autori ka ceduar duke hequr skafandrën çka do të bënte të mundur identifikimin e tij.


LEXO EDHE:
Shiroka e fëmijëve, e 'gjarpërinjve që pinë ujë në liqen' dhe 'a ke punë me kënd?'

Ngelet ende enigmë nësë 57-vjeçari është thirrur nga një person për të dalë nga banesa edhe pse në momentin e ngjarjes, ai ka qënë disa metra larg banesës së tij pranë një dyqani të vogël duke konsumuar një birrë.

Ndërkohë nga ana tjetër, Policia e shkodrës ka shoqëruar deri tani 8 persona në ambjentet e komisariatit si dëshmitarë në vendin e ngjarjes dhe persona që kanë dijeni për këtë atentat. Në personat që janë shoqeruar nga policia e Shkodrës për të dhënë dëshmi, është edhe ***25 vjeçari Alban Bruçi*** së bashku me të atin e tij, kjo sepse djali i viktimës, Bajram Çekorja, është në kërkim si autor i dyshuar. Policia në një nga pistat e hetimit ka atë të hakmarrjes dhe për këtë arsye ka thirrur për të dëshmuar edhe Alban Bruçi, i cili i shpëtoi atentatit mbrëmjen e 25 Gushtit.

Megjithate, Policia e Shkodrës ka ngritur disa pista hetimi në lidhje më këtë ngjarje pasi nuk përjashtohen edhe pista të tjera hetimi pasi djali i tij, ***Bajram Çekorja*** ka qënë dy herë i ndaluar nga Policia e Shkodrës ndërkohë që ai ka qënë i përfshirë në disa ngjarje në Shkodër.

B.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: ismet cekorja | Ekzekutimi i Ismet Çekorjas | Shkoder | Alban Bruçi

Komente

Lomi tirones: 03/09/2022 12:13
Cere osht kja pun kshu mer jahu , puquni mer me njoni tjetrin Bohuni shok e miq pini nai got raki , armet hudhni mplena ,

Kuku isuf: 03/09/2022 11:50
Po cfare albanit mor hahhahah ky nuk asht i zoti me qu brekt e vedi jo me qit pushk , ky hala se ka marr vedin prej asaj ca i ka ndodh

Hahahihihuhu: 03/09/2022 13:01
Ska gja Asmeri e ka ba , Albani ban burg e njejta gja asht .respekt

Shqiperia Po Ndryshon: 03/09/2022 11:45
Hajde komentues te papune, turruni komenteve si turku sumes se jeni gallate.

Moli: 03/09/2022 12:14
Fal teje shqiperia po ndryshon o komentues me pune

I papun: 03/09/2022 12:10
I madh je ahahahaha Po deti dje i thoshin qe kush nuk ka pune luan me deren ta ni kush nuk ka pune ja fut ca komente ??????????????????????

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si e vlerësoni vendimin e qeverisë për të nisur një operacion kundër lidhjeve të paligjshme të energjisë?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Vritet në Shkodër Ismet Çekorja, i biri në kërkim për atentatin ndaj Bruçit! Viktima e paralajmëroi 4 ditë më parë: Familjes sime i janë qepur shteti e bandat! (VIDEO)
2 Shtator, 14:59

Kronikë

Shpallen në kërkim 2 vëllezër në Vaun e Dejës! Goditën 28-vjeçarin në kokë me tytën e çiftes
1 Shtator, 14:57

Të shtëna me armë zjarri në Malësi të Madhe, qëllohet me breshëri plumbash drejt një banese
31 Gusht, 15:09

Kronikë

Akuzohen për abuzim me tenderin për rikonstruksionin e Komisariatit në Shkodër, Gjykata e Apelit liron 7 policët, me tyre Saimir Rustemi
Ergys Kavaja
30 Gusht, 12:17

Kronikë

Atentati i dështuar në Shkodër/ Flet babai i autorit të dyshuar: Kam video, djali s'ka lidhje! (Kontradikta me pamjet që i hedh poshtë alibinë)
29 Gusht, 14:03

Kronikë

Aksident i rëndë në Shkodër, mjeti përplaset me murin dhe kthehet përmbys në mes të rrugës (VIDEO)
28 Gusht, 19:36

Kronikë

Tentuan të trafikonin kanabis, kateminë dhe ekstazi drejt Malit të Zi, arrestohen 4 persona në pikën kufitare të Muriqanit (EMRAT)
28 Gusht, 10:50

Kronikë

Atentati i dështuar ndaj Alban Bruçit në Shkodër, shpallen në kërkim autorët! Një prej tyre djali i biznesmenit dhe ish-presidentit të Vllaznisë
27 Gusht, 18:17

Kronikë

Shkodër/ I shpëtoi atentatit një natë më parë, zbardhet dëshmia e 25-vjeçarit: Ishin dy persona me motor, njëri më qëlloi drejt makinës! S'kam konflikte
26 Gusht, 10:09

Kronikë

Përfshihet nga flakët banesa në Shkodër, shkak shkëndija elektrike (VIDEO)
25 Gusht, 22:25

Kronikë

Atentat me armë zjarri në lagjen 'Rus' në Shkodër, qëllohet me breshëri plumbash në drejtim të 25-vjeçarit! Në 2016 u arrestua pasi tentoi të vriste një person
25 Gusht, 21:45

Kronikë

Sekuestrohen mbi 200 mijë euro në Muriqan, nën hetim 53-vjeçari! Dyshohet se janë fituar nga krimi
25 Gusht, 15:51

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje